

Школа за претприемништво

ОД ИДЕЈА ДО СТАРТАП

Пријавување до
06.02.2019



Çka:

Forumi Arsivor Rinor (FAR) në bashkëpunim me Institutin për Politikë Evropiane (IPE) hap thirrje për pjesëmarrës në **Shkollën për sipërmarrës "Nga Ideja deri në startap"** në kuadër të projektit "Angazhimi i sektorit privat në arsimin për sipërmarrësi" dhe (Engaging the Private Sector in Entrepreneurship Education). Programi do të realizohet në Shkup në periudhën nga shkurti deri në maj 2019.

Gjatë programit do të studiohen temat si mëposhtë:

1. Çfarë është sipërmarrësi?
2. Motivimi, lidhshipi dhe puna në grup
3. Historia, prezantimi dhe prototipi
4. Marketing tradicional dhe online
5. Udhëheqja e biznesit

Shkolla do të realizohet dy herë në javë pasdite dhe do të përfshijë aktivitete siç janë biseda me sipërmarrës të suksesshëm, simulime, studime të rasteve, punë praktike dhe leksione shtesë të hapura. Programi arsimor do të fillojë me trajnim intensiv dy ditor gjatë fundjavës.

Për kë është i dedikuar ky trajnim?

Aplikoni nëse:

- Jeni të papunë dhe kërkoni punë në sektorin privat ose dëshironi të filloni biznesin tuaj;
- Jeni 21-29 vjeç;
- Keni interes në krijimin e startapeve ose fillimin e një biznesi
- Ju motivojnë sfidat, keni dëshirë për të krijuar qasje të reja dhe inovative për zgjidhjen e problemeve, dëshironi të eksperimentoni me idetë e biznesit;
- Keni mundësinë të merrni pjesë në të gjitha trajnimet;
- Tregoni nivel të lartë të gatishmërisë dhe përkushtimit;
- Nuk keni problem të dilni jashtë zonës suaj të rehatisë;
- Dëshironi të punoni në ekip.

Si të aplikoj?

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë deri më 06 shkurt 2019, duke dërguar CV dhe të plotësojnë aplikacionin në obuki@mof.org.mk.

Numri i pjesëmarrësve është i kufizuar. Përzgjedhja e pjesëmarrësve do të bëhet nga komisioni i përbërë nga përfaqësuesit të Forumit Arsivor Rinor dhe Institutit për Politika Evropiane. Sipas kërkesës, do të

Школа за претприемништво

ОД ИДЕЈА ДО СТАРТАП

Пријавување до
06.02.2019



kryhen intervistat (telefonike ose personale) me aplikuesit. Programi është falas dhe do të zhvillohet në gjuhën maqedonase. Ndaj thirrjes gjithashtu mund të aplikojnë edhe ekipe, duke deklaruar në aplikacionin që aplikojnë me një ide biznesi të sajuar paraprakisht.

Çfarë do të fitoj?

Një program edukimi cilësor që do t'ju mundësojë të zhvilloni kapacitetet tuaja!
Gjatë gjithë programit pjesëmarrësit do të formojnë ekipe dhe do të kenë mundësinë të aplikojnë për mbështetje financiare për propozim idenë e tyre të biznesit. Të gjitha ekipet do të pajisen me mentorim nga profesionistë me përvojë në sektorin e biznesit. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të njihen, të mësojnë dhe të bashkëpunojnë me pronarët e bizneseve të suksesshme, ligjërues të shkëlqyeshëm, mentorë, këshilltarë, profesorë dhe profesionistë. Të gjithë pjesëmarrësit të cilët do të ndjekin trajnimin do të marrin certifikatë.

Një program i tillë u organizua në vitet 2016-2017 me 12 trajnime të suksesshme për 40 të rinj, në dy fusha të aftësive të buta: sipërmarrësi dhe pjesëmarrje qytetare.
Si rezultat i programit, u mbështetën dy startape lokale: Ushqim për të Gjithë dhe Audified Reality, me fondin e startapit dhe mentorimin.

*Programi do të bëhet i mundur me mbështetjen e **Qendrës për Sipërmarrësi Private Ndërkombëtare (CIPE)**.*

Na kontaktoni për më tepër informata:
obuki@mof.org.mk 02/3139 692
Personi për kontakt: Sanja Stefanovikj